

## **RELACION**

### **PËR**

### **PROJEKTVENDIMIN**

**“PËR MIRATIMIN E KRITEREVE PËR IDENTIFIKIMIN E SUBJEKTEVE PRIVATE, STRUKTURAT PËRGJEGJËSE PËR IDENTIFIKIMIN E TYRE, SI DHE RREGULLAT PËR REALIZIMIN E BASHKËPUNIMIT NDËRMJET TYRE”**

#### **I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN**

Ky projektvendim ka si qëllim miratimin e procedurave për identifikimin e subjekteve private, të cilat duhet të lejojnë për qëllime të paralajmërimit të hershëm, të monitorimit, njoftimit dhe alarmit, instalimin në objektet në pronësi të tyre apo për të cilat kanë të drejta reale, të mjeteve dhe sistemeve të dhënies së alarmit, si dhe rregullat për realizimin e bashkëpunimit ndërmjet tyre dhe subjekteve përgjegjëse për identifikimin.

Projektvendimi synon mundësimin e paralajmërimit të hershëm të popullatës, subjekteve të tjera private, organeve shtetërore etj., si dhe monitorimin e vazhdueshëm, njoftimin dhe alarmin në rastet e situatave të shkaktuara nga fatkeqësitet natyrore dhe fatkeqësitet e tjera.

#### **II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT, NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Projektvendimi është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analistik të Projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, për katërmujorin e tretë të vitit 2021, për Ministrinë e Mbrojtjes.

#### **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Ky projektvendim është i domosdoshëm, pasi nëpërmjet tij përcaktohen detyrimet e subjekteve private dhe atyre publike lidhur me funksionimin, mirëmbajtjen dhe kontrollin e mjeteve dhe të pajisjeve të paralajmërimit të hershëm, monitorimit, njoftimit dhe alarmit, gjë e cila do të ndikojë

---

Relacioni shpjegues për projektvendimin “Për miratimin e kritereve për identifikimin e subjekteve private, strukturat përgjegjëse për identifikimin e tyre, si dhe rregullat për realizimin e bashkëpunimit ndërmjet tyre”.

drejtpërsëdrejti në menaxhimin efektiv të situatave të ndryshme të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera.

Gjithashtu, në këtë projektvendim përcaktohen kriteret për përfshirjen e subjekteve private në infrastrukturën e paralajmërimit të hershëm, monitorimit, njoftimit dhe alarmit, pasi një kategorizim dhe listim i tyre është i domosdoshëm për një proces identifikimi sa më eficient.

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI, VENDAS DHE ATË NDËRKOMBËTAR.**

Ky projektvendim është në harmoni të plotë me rendin e brendshëm juridik dhe atë ndërkombëtar. Projektvendimi propozohet në bazë të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 51, të ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”.

#### **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS TË BE*.**

Projektvendimi nuk synon përafrimin me legjislacionin komunitar.

#### **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT.**

Projektvendimi përbëhet nga 6 pikë:

Në pikën e parë është përcaktuar se Këshilli i Ministrave vendos për miratimin e procedurave për identifikimin e subjekteve private dhe të bashkëpunimit ndërmjet tyre dhe subjekteve përgjegjëse për identifikimin.

Në pikën 2 të projektvendimit janë përcaktuar bashkitë, prefekti i qarkut dhe Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile si struktura përgjegjëse për identifikimin e subjekteve private, të cilët do të përfshihen në infrastrukturën e paralajmërimit të hershëm, monitorimit, njoftimit dhe alarmit.

Në këtë pikë janë parashikuar në mënyrë të detajuar edhe përgjegjësitë që ka secila nga strukturat e sipërpërmendura, ku vlen të theksohet kryerja e identifikimit të subjekteve private brenda territorit ku strukturat përgjegjëse ushtrojnë veprimtarinë e tyre, si dhe informimi ndërinstitucional.

Germa “c”, e pikës 2 të projektvendimit parashikon gjithashtu, detyrimin e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile për mbajtjen e një regjistri në rang kombëtar, për listën e subjekteve të identifikuara.

---

Relacioni shpjegues për projektvendimin “Për miratimin e kritereve për identifikimin e subjekteve private, strukturat përgjegjëse për identifikimin e tyre, si dhe rregullat për realizimin e bashkëpunimit ndërmjet tyre”.

Në pikën 3 të projektvendimit janë parashikuar kriteret për identifikimin e subjekteve private, të cilat do të përfshihen në infrastrukturën e paralajmërimit të hershëm, monitorimit, njoftimit dhe alarmit.

Kriteret e parashikuara në këtë pikë kanë të bëjnë më së shumti me garantimin e shikueshmërisë dhe dëgjueshmërisë së alarmeve, si dhe transmetimin e paralajmëimeve dhe njoftimeve të ndryshme në lidhje me situatat konkrete apo potenciale të fatkeqësisë.

Në pikën 4 të projektvendimit janë të parashikuara veprimet që do të duhet të ndërmerren nga subjektet private dhe strukturat përgjegjëse për identifikimin në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet tyre.

Në këtë pikë janë parashikuar si detyrime të subjekteve private, lejimi i hyrjes së personelit të ngarkuar me mirëmbajtjen dhe funksionimin e mjeteve dhe të pajisjeve të paralajmërimit të hershëm, monitorimit, njoftimit dhe alarmit, si dhe lejimi i ushtrimit të kontrollit nga strukturat përgjegjëse të parashikuara në pikën 2 të projektvendimit, të mjeteve dhe të pajisjeve të paralajmërimit të hershëm, monitorimit, njoftimit dhe alarmit, të vendosura në objektin e tyre.

Nga ana tjetër, si detyrim i strukturave përgjegjëse, të cilat kryejnë identifikimin e subjekteve private, është parashikuar njoftimi në çdo rast dy ditë pune përpara, i këtyre të fundit, për hyrjet e personelit të ngarkuar me mirëmbajtjen e funksionimin e mjeteve dhe të pajisjeve të paralajmërimit të hershëm etj. (përveç rasteve emergjente kur pajisjet janë dëmtuar apo janë jashtë shërbimit), si dhe për kontrollet që do të ushtrohen në subjektet private.

Në pikën 5 të projektvendimit, me qëllim shhangjen e mbingarkesës së subjekteve private me kontolle nga strukturat përgjegjëse (sipas pikës 2 të projektvendimit), është parashikuar që këto struktura mund të koordinojnë punën për kryerjen e kontrolleve të përbashkëta.

## VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT.

Për zbatimin e këtij vendimi do të ngarkohen strukturat përgjegjëse për identifikimin e subjekteve private të cilët do të përfshihen në infrastrukturën e paralajmërimit të hershëm, monitorimit, njoftimit dhe alarmit.

## VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektvendim, është hartuar nga Ministria e Mbrojtjes dhe Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile.

---

Relacioni shpjegues për projektvendimin “Për miratimin e kritereve për identifikimin e subjekteve private, strukturat përgjegjëse për identifikimin e tyre, si dhe rregullat për realizimin e bashkëpunimit ndërmjet tyre”.

Projektvendimi do të dërgohet për mendim pranë Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Drejtësisë, Këshillit Konsultativ Qeveri Qendrore dhe Vetëqeverisje Vendore, Autoritetit të Mediave Audiovizive dhe Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

#### **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE.**

Ky projektvendim nuk ka efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit



---

Relacioni shpjegues për projektvendimin "Për miratimin e kritereve për identifikimin e subjekteve private, strukturat përgjegjëse për identifikimin e tyre, si dhe rregullat për realizimin e bashkëpunimit ndërmjet tyre".